



Data: 05.02.2019

Ref.: 144119 D

Në mbështetje të Nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

1. Tërhiqet akreditimi i programeve të studimit të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka" si më poshtë:
 - Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSC 120 ECTS;
2. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Sipas Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *"IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor"*, IAL janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik më së largu deri më 31 tetor 2018. Sipas pikës 3 të Nenit 30 të UA për Akreditim, *"Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit"*.

Pas deklarimit të stafit akademik të IAL-ve, AKA ka bërë verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të plotësisë apo jo të kritereve ligjore për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, KShC analizo të gjithë dokumentacionin e secilit staf akademik të vendosur si bartës të programeve nga IAL-të dhe mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për programin e studimit: *Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSC 120 ECTS*, bartës në këtë program Universiteti "Haxhi Zeka" (tash e tutje Universiteti) ka paraparë këtë staf: Theranda Beqiri (PhD në Shkenca Ekonomike) dhe Vehbi Miftari (PhD Shkenca Filologjike).


Ky program ka 120 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Universiteti duhet të ketë të paktën dy staf akademik me gradën akademike PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga Universiteti, për këtë program të studimit, u konstatua që Vehbi Miftari është PhD në Shkenca Filologjike dhe nuk i përket fushës së programit të studimit *Menaxhim i Burimeve Njerëzore*, dhe rrjedhimisht nuk mund të jetë bartës i programit të studimit. Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim të tërheq akreditimin për programin e studimit *Menaxhim i Burimeve Njerëzore, MSC 120 ECTS*

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqites ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka";
- MASHT-it; dhe
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë